

Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror “Nënë Tereza” shpall:

K O N K U R S
për ndarjen e Çmimit Shtetëror “Nënë Tereza” në vitin 2019.

Me Çmimin Shtetëror “Nënë Tereza” jepet mirënjohja për arritjet në fushën e humanizmit dhe solidaritetit njerëzor dhe për nxitjen, avancimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe zhvillimin e bashkëpunimit sikurse midis popujve, ashtu edhe midis pjesëtarëve të komuniteteve, kulturave dhe feve të ndryshme.

Çmimi Shtetëror u ndahet individëve, grupit të krijuesve, ekipeve, institucioneve, shoqërive tregtare dhe shoqatave të qytetarëve të vendit.

Çmimi Shtetëror me kushtet e caktuara në konkurs mund t’u ndahet edhe shtetasve të huaj, grupit të krijuesve, ekipeve dhe institucioneve të huaja.

Individi që do ta fitojë këtë Çmim i ndahet: diploma dhe shuma në para.

Çdo anëtar i grupit të krijuesve ose ekipit që do ta fitojë këtë Çmim u ndahet diploma dhe pjesa e barabartë e shumës në para.

Institucioni, shoqëria tregtare ose shoqata e qytetarëve që do ta fitojë këtë Çmim u ndahet diploma dhe plaketa.

Shuma në para e Çmimit Shtetëror “Nënë Tereza” është *pesë (5) rroga mujore mesatare* në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paguara në tri muajt e fundit të vitit rrjedhës.

Çmimi Shtetëror “Nënë Tereza” ndahet, sipas rregullit, çdo vjet.

Në një vjet mund të ndahen më së shumti deri në *dy çmime*.

Iniciativë për ndarjen e Çmimit Shtetëror “Nënë Tereza” mund të parashtrojnë: institucionet, shoqëritë tregtare, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e Çmimit Shtetëror duhet hollësisht ta arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të përmbahen edhe: *të dhënat e sakta të biografisë, adresa e saktë e vendbanimit (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhënat për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur ajo dhe të dhënat e tjera që konsiderohen se do të kontribuojnë në vlerësim, si dhe dokumentacioni përkatës me të cilin do të konfirmohen ato.*

Parashtruesi i iniciativës duhet ta theksojë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe telefonin.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dërgohet në 15 ekzemplarë, ndërsa punimet (librat, publikimet, etj.) trajtohen si shtojcë dhe duhet të dërgohen në një (1) ekzemplar.

Adresa në të cilën duhet të dërgohen iniciativat është:

Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror “Nënë Tereza”, rr. “Gjuro Gjakoviq” nr. 61 - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Konkursi do të zgjasë nga 1 deri më 30 prill 2019.

Iniciativat e pakompletuara dhe iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet, etj.) të dërguara pas afatit të caktuar për t’i pranuar në konkurs nuk do të shqyrtohen.

**Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror
“Nënë Tereza”**